



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 212/8 Prot.

Tiranë, më 7.3.2023

Lënda: Mbi fillimin e bisedimeve për kontratën kolektive

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ✓

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, DURRËS

Adresa: Lagja Nr. 12, Rruga "Mujo Ulqinaku", te Shkolla "Marie Kaçulini", Durrës

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, FIER

Adresa: Lagja "Kastriot", Rruga "Leon Rei", Fier

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, KORÇË

Adresa: Rruga "Dhimitër Denasi", Korçë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, LEZHË

Adresa: Sheshi "Gjergj Kastrioti", Lezhë

Në vijim të përfundimit të afatit të kontratës kolektive nr. 6145 prot., datë 05.06.2018 dhe në zbatim të nenit 163 të Kodit të Punës, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka shpallur njoftimin nr. 212/6 prot., datë 06.03.2023 "Për fillimin e bisedimeve mbi nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë" për fillimin e bisedimeve me Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë (FSASH) dhe Sindikatë së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH), si organizatat sindikale më të përfaqësuara, të cilat kanë deklaruar se do të hyjnë së bashku në bisedime për nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, në zbatim të nenit 163 të Kodit të Punës, ku përcaktohet se punëdhënësi, të cilit i është kërkuar fillimi i bisedimeve, duhet ta bëjë kërkesën publike, duke e afishuar në mënyrë të dukshme gjatë dy javëve në institucionet përkatëse, të përcjellin këtë njoftim te Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, si dhe të marrin masa për publikimin e njoftimit të sipërcituar, bashkëlidhur kësaj shkrese, sipas afatit ligjor të përcaktuar, në këndet e informacionit të institucionit dhe në faqet zyrtare, për të gjitha strukturat e arsimit parauniversitar, si dhe të njoftohen mësuesit për fillimin e bisedimeve për kontratën e re kolektive në fushën e mësuesisë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI PËRGJITHSHËM



Erzen Tola



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 212/16 Prot.,

Tiranë, më 6.3. 2023

Lënda: Njoftim për fillimin e bisedimeve mbi nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë

FEDERATËS SË SINDIKATAVE TË ARSIMIT DHE SHKENCËS (FSASH)

Adresa: Rr "Perlat Rexhepi", Pallati i Sokol Komanit, Shkalla 2, Kati 7, AP.21

Tiranë

SINDIKATËS SË PAVARUR TË ARSIMIT TË SHQIPËRISË (SPASH)

Adresa: Rr "Perlat Rexhepi", Pallati i Sokol Komanit, Shkalla 2, Kati 7, AP.21

Tiranë

*Për dijeni: **KONFEDERATËS SË SINDIKATAVE TË SHQIPËRISË***

Adresa: Sheshi Garibaldi", Rr "Shaban Bardhoshi", Njësia Bashkiake nr.6, Kombinat

Tiranë

Të nderuar Zotërinj,

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, konform njoftimit nr. 212/2 prot., datë 13.01.2023, mbi fillimin e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë, Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH) dhe Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH) kanë depozituar së bashku kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm, respektivisht nëpërmjet shkresës nr. 402 prot., datë 26.01.2023.

Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH) dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH), konform pikës 1, të nenit 163 të Kodit të Punës, në të cilën parashikohet se: "*.....Shumë organizata sindikale mund ta ushtrojnë këtë të drejtë së bashku*", nëpërmjet shkresës nr. 402 prot., datë 26.01.2023, kanë deklaruar se do të hyjnë në bisedime dhe do ta nënshkruajnë së bashku Kontratën Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga ana juaj, shqyrtimit të treguesve të përfaqësueshmërisë, si dhe duke u bazuar në pikën 2, të nenit 164 të Kodit të Punës, në të cilin parashikohet se: "***Organizata që provon se ka numrin më të madh të anëtarëve punëmarrës në ndërmarrje ose degë, vlerësohet si organizata më e përfaqësuar. Nëse disa organizata sindikale paraqiten së bashku, vlerësohet më i përfaqësuar grupi i organizatave që ka numrin më të madh të anëtarëve***", vlerësohet se organizatat sindikale më të përfaqësuara janë Federata e

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al

www.arsimi.gov.al

Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH) dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH), të cilat deklarojnë se do të hyjnë së bashku në bisedime për nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë.

Për sa më sipër, bazuar në procedurat ligjore të parashikuara në pikën 4, të nenit 163 të Kodit e Punës, ku përcaktohet se: *“Punëdhënësi, të cilit i është kërkuar fillimi i bisedimeve, duhet ta bëjë kërkesën publike, duke e afishuar, në mënyrë të dukshme, gjatë dy javëve, në ndërmarrje. Nëse kërkesa është bërë në nivel dege, ajo duhet të afishohet në të gjitha ndërmarrjet ose degët. Organizata ose organizatat sindikale, që kërkojnë fillimin e bisedimeve, duhet të kujdesen që afishimi të kryhet në mënyrë të rregullt”*, njoftojmë fillimin e bisedimeve për nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë me Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH) dhe Sindikatën e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH), të cilat deklarojnë se do të hyjnë së bashku në bisedime për nënshkrimin e saj.

Duke ju falënderuar,

MINISTËR

EVIS KUSHI

